



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:067299

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06289373

C.nr.1210/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.K. përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore nëna – Sh.K. nga fshati Komuna e Prizrenit , e këtë me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni , kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ Prisig “ me seli në Prishtinë me objekt të padisë kompensim i dëmit , me vlerë të kontestit 1000€, jashtë seance me datë **11.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e S.K. nga fshati Komuna e Prizrenit , me të cilën ka kërkuar që të “**OBLIGOHET e paditura që të paguaj vlerën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 1,00.00 euro paditësit me kamatë ligjore prej 8 duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë gjer në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit ekzekutues**”.

II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi – S.K. përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore nëna – Sh.K. nga fshati Komuna e Prizrenit , të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 05.04.2022, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ Prisig “ me seli në Prishtinë , me objekt të padisë kompensim i dëmit , vlera e kontestit 1000€.

I autorizuari i paditësit av.B.M. nga Prizreni përmes parashtrësës së datës 27.09.2024 të cilën e ka dorëzuar në gjykatë ka njoftuar se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial dhe mbi këtë bazë në mungesë të interesit juridik për vazhdim të ndjekjes së çështjes

përmes Gjykatës bëjmë heqje dorë nga kërkesëpadia , duke u bazuar në nenin 149 të LPK-së.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi që të njëjtat të bien në barrë të palës paditëse.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 149.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1210/2022, 11.10.2024

Gj y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.